

V E N D I M

“Vendosje sekuestro preventive”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR - SOKOL TONA

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Dasantila Bejko**, sot më dt.**23 Prill 2012**, me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane, përfaqësuar nga prokurori **Z.Gentian Osmani**, si mori në shqyrtim kerkesen penale me nr.754 akti qe i perket:

KERKUES Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane.

OBJEKTI: Vendosjen e sekuestros preventive ne kuader te hetimeve te proçedimit penal nr.1181 te viti 2012.

Baza ligjore: Nga Neni 274 i Kodit Proçedures Penale.

Gjykata ne perfundim te shqyrtimit gjyqësor pasi administroi provat ftoi prokurorin ne bisedimet perfundimtare ku prokurori kerkoj pranimin e kerkeses sipas objektit.

V E R E N

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane i eshte drejtuar me kerkese kesaj gjykate, siç percaktohet ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kesaj kerkese, rezulton se ajo nuk eshte rezultat i nje argumentimi ligjor dhe e mbeshtetur ne Ligj dhe per pasoje duhet te rrezohet.

Keshtu, organi i prokurorisë faktin objekt te ketij shqyrtimi gjyqësor ia parashtroi ne menyren si vijon:

Në datë 08.03.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar proçedimin penal Nr. 1181 për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga Neni 287 i Kodit Penal.

Proçedimi eshte regjistruar bazuar ne materialet e referuara dhe verifikimet e kryera nga Seksioni Kunder Pastrimit te Parave ne Drejtorine e Policise se Qarkut Tirane. Per shtetasin V.Bi dtl. (.....) dhe familjare te tij sipas organit te akuzes, ka dyshime te bazuara ne lidhje me shumate e investuara ne biznese dhe pasuri te paluajtshme dhe origjinen e ketyre shumave. Pasurite jane te regjistruara ne emer te shtetasit V.B dhe te prinderve te tij shtetasve B dhe D.B. Nderkohe qe burim i ketyre pasurive dyshohet te jene te ardhura me origjine nga aktivitetet kriminale te shtetasit V.B. Ne emer te familjareve te V.B ka levizje te shumta

transfertash bankare ne shifra te konsiderueshme dhe te pajustificuara nga pikepamja ekonomike.

Nga veprimet e kryera ka rezultuar:

Persa i perket aktiviteteve kriminale te shtetasit V.B:

Me vendimin Nr. 368 Akti dt. 15.04.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur: Njohjen e Vendimit Penal Nr. 1592 Regj. Denimeve te Gjykates se Apelit Torino – Itali dt. 13.04.2007 i formes se prere me date 02.06.2007 per te denuarin V.B dhe denimin e tij me 8 (tete) vjet burgim per vepren penale te “Shfrytezimit te prostitucionit ne rrethana renduese” parashikuar nga Neni 114/a e 25 te Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tirane me vendimin Nr. 1397 dt. 15.12.2011 ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit Nr. 368 Akti dt. 15.04.2011 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me nje ndrshim ne caktimin e denimit, duke e denuar 7 (shtate) vjet burgim.

Per kete qellim Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane ka nxjerre urdherin per ekzekutimin e vendimit penal.

Jane zhvilluar veprime hetimore lidhur me aktivitetet tregtare dhe me pasurite e paluajtshme dhe te luajtshme qe shtetasi V.B apo te aferm te tij kane ne pronesi ne Shqiperi.

Duke permbledhur te dhenat e administruara deri ne keto momente rezulton se:

Qendra Kombetare e Regjistrimit ka kthyer pergjigje se:

V.B eshte regjistruar ne regjistrin tregtar si person fizik me vendimin Nr. 30571 dt. 15.02.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Vendi i ushtrimit te aktivitetit ishte Bar – Hotel “..... me adrese Rr.”, fusha e veprimtarise Bar - Hotel. Me aplikimin me numer CN-267174-06-09, dt. 30.06.2009 subjekti ne fjale ka aplikuar per ç`regjistrim nga regjistri tregtar, aplikim ky i refuzuar nga QKR-ja.

B A.B eshte ortak zoterues i 100 % te kuotave te kapitalit themeltar ne sh.p.k “B” regjistruar me vendim Nr. 18164 dt. 20.11.1997 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ne dt. 02.07.2009 eshte regjistruar subjekti “Alfatino” sh.p.k me perfaqesues ligjor shtetasin A.B.

Nga Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane jemi informuar se ne emer te shtetasit V.B dhe te prinderve te tij D dhe B jane te regjistruara keto pasuri:

1.Pasuria me nr. (.....), Zona Kadastrale 8270, Vol. 6, fq. 204, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise apartament, me siperfaqe totale 71.1 m/2 ne pronesi te shtetases D.B regjistruar ne dt. 05.07.2000.

2.Pasuria me nr(.....), Zona Kadastrale 8270, Vol. 6, fq. 205, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise apartament, me siperfaqe totale 47.4 m/2 ne pronesi te shtetases D.B regjistruar ne dt. 11.05.2011.

3.Pasuria me nr. (.....) Zona Kadastrale 8270, Vol. 64, fq. 114, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise godine, me siperfaqe totale 110.4 m/2 ne pronesi te shtetases D.B, regjistruar ne dt. 09.12.2011.

4. Pasuria me nr. (.....), Zona Kadastrale 8270, Vol. 64, fq. 115, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise Njesi, me sipërfaqe totale 25 m/2 ne pronesi te shtetases D.B, regjistruar ne dt. 12.08.2010.
5. Pasuria me nr. (.....), Zona Kadastrale 8270, Vol. 64, fq. 116, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise Njesi, me sipërfaqe totale 25 m/2 ne pronesi te shtetases D.B, regjistruar ne dt. 12.08.2010.
6. Pasuria me nr. (.....), Zona Kadastrale 8270, Vol. 57, fq. 122, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise apartament, me sipërfaqe totale 107.2 m/2 ne pronesi te shtetases D.B, regjistruar ne dt. 30.09.2009.
7. Pasuria me nr. (.....), Zona Kadastrale 8270, Vol. 57, fq. 121, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise apartament, me sipërfaqe totale 107.2 m/2 ne pronesi te shtetases D.B, regjistruar ne dt. 30.09.2009.
8. Pasuria me nr. (.....)Zona Kadastrale 8270, Vol. 6, fq. 124, me adrese Rr.”” – Tirane. Lloji i pasurise apartament, me sipërfaqe totale 64 m/2 ne pronesi te shtetasit B .B, regjistruar ne dt. 12.02.2008.
9. Pasuria me nr. (.....)Zona Kadastrale 8270, Vol. 42, fq. 46, me adrese Tirane. Lloji i pasurise apartament, me sipërfaqe totale 147 m/2 ne pronesi te shtetasit B .B, regjistruar ne vitin 2003.
10. Pasuria ne Zonen Kadastrale (.....), Nr. regjistri 442, Nr. rendor 58, Rr., Tirane prane ish-uzines Dinamo. Lloji i pasurise lokal, me sipërfaqe totale te truallit 750 m/2, me sipërfaqe ndertimore 452 m/2, sipërfaqe oborri 298m/2, regjistruar ne dt.16.06.2001 ne emer te shtetases D.B.
11. Pasuria me nr(.....), Zona Kadastrale 8270, Vol. 39, fq. 40, me adrese Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise bodrum, me sipërfaqe totale 13.75 m/2 ne pronesi te shtetasit V.B, regjistruar ne dt. 12.06.2008.
12. Pasuria me Nr. regjistri (.....), Nr. rendor 1529, Rr.”.....” – Tirane. Lloji i pasurise shtepi banimi ndertuar ne truallin me sipërfaqe 775 m/2 blere ne dt. 15.04.1998. Kjo pasuri nuk eshte e regjistruar pasi truallin nuk eshte i mbeshtetur ne origjine.

Per sa siper, sipas organit te akuzes, ekziston dyshimi i arsyeshem qe nga shtetasi V.Bte jete kryer vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga Neni 287 i Kodit Penal.

Aktiviteti kriminal i shtetasit V.B provohet plotesisht nga fakti qe eshte i denuar me vendim te formes se prere nga autoritetet e drejtesise italiane, vendim i cili eshte njohur nga autoritetet shqiptare.

Parate e siguruar nga ky aktivitet jane investuar ne pasuri te paluajshme te vendosura ne emer prinderve te tij, shtetasve D dhe B .B.

Ne Nenin 274/2 te Kodit te Proçedures Penale eshte parashikuar: “Sekuestroja mund te vendoset edhe per sendet, produktet e vepres penale dhe çdo lloj pasurie tjeter qe lejohet te konfiskohet, sipas Nenit 36 te Kodit Penal.”

Sipas organit te akuzes, per sa siper, jemi para rastit te vendosjes se sekuestros preventive pasi kemi te bejme me produkte te vepres penale qe rrjedhin ose fitohen drejtperdrejt ose terthorazi nga kryerja e vepres penale, e cila eshte "Trafikimi i lendeve narkotike" parashikuar nga Kodi Penal Shqiptar ne Nenin 283/a.

Kjo veper penale eshte kryer jashte shtetit shqiptar, ne Itali.

Ne funksion te kerkeses si me siper, organi i akuzes i paraqiti kesaj gjykate edhe dokumentacionin e administruar nga institucionet perkatese rreth pasurive dhe objekteve te sipercituara.

Ne konkluzionin sipas te cilit kerkesa objekt gjykim duhet te rrezohet, gjykata arrin duke konsideruar sa vijon:

Keshtu ne rastin ne gjykim dhe me provat e administruara sillet bindja se shtetasi V.B, eshte shtetas shqiptar dhe me precedent penal, ku tashme ai kerkohet nga drejtesia, ne zbatim te urdherit te ekzekutimit te vendimi te denimit te tij me 7 vite burgim per kryerjen e vepres penale te "Shfrytezimit te prostitucionit ne rrethana renduese" parashikuar nga Neni 114/a e 25 te Kodit Penal.

Po keshtu sillet bindja edhe ne faktin se shtetasit D dhe B .B jane prinderit e tij, si edhe A.B eshte vellai i tij, ne emer te te cileve figurojne pasurite e sipercitua.

Por sic u sipertregua, organi i akuzes ndonese ne menyre te shprehur ne kerkesen objekt gjykim citon se: ".Parate e siguruara nga ky aktivitet jane investuar ne pasuri te paluajtshme te vendosura ne emer prinderve te tij, shtetasve D dhe B.B.", ai organ nuk i paraqiti kesaj gjykate asnje prove, e cila te sherbeje si nje dyshim i arsyeshem dhe i mjaftueshem, qe realisht pasurite ne emer te shtetasve D dhe B.B apo dhe A.B e kane burimin nga aktiviteti kriminal i familjarit te tyre. Vetem faktin se shtetasit D dhe B .B, jane prinderit e shtetasit V.B, gjykata e konsideron te pamjaftueshem, per te vendosur sekuestron mbi te gjitha pasurite e tyre.

Do te krijonte dyshimin e arsyeshem per gjykatën dhe per pasoje edhe nevojën e vendosjes se sekuestros preventive mbi pasurite e mesiperme, paraqitja e akteve te tilla te cilat te dokumentonin, pikerisht lidhjet e paleve te mesiperme ne veprime te tilla si transferta financiare, transaksione te ndryshme, akte ligjore shitjesh, dhurimi apo blerjesh, midis shtetasit V.B dhe familjareve te tij.

Ne kushtet e mungeses se akteve te tilla, gjykata nuk e konsideron nje veprim juridik te motivuar vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite e bashkeshorteve D dhe B.B, vetem per faktin se ata jane prinderit e shtetasit V.B, ne nje kohe qe nga aktet e administruara, ata rezultojne te kene edhe femije te tjere.

Po keshtu, ndonese ne materialin e paraqitur nga ana e organit te akuzes, ne menyre te shprehur citohet se "jemi para rastit te vendosjes se sekuestros preventive pasi kemi te bejme me produkte te vepres penale qe rrjedhin ose fitohen drejtperdrejt ose terthorazi nga kryerja e vepres penale e cila eshte "Trafikimi i lendeve narkotike" parashikuar nga Kodi Penal

Shqiptar ne Nenin 283/a; veper penale kjo per ekzistencen e te ciles kesaj gjykate, nuk iu paraqit asnje prove.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar te Nenit 274 te Kodit Proçedures Penale:

V E N D O S I

-Rrezimin e kërkesës me nr.754 akti dt.23.04.2012 si te pabazuar ne prova.

-Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

U shpall sot në Tiranë më datë 23 Prill 2012.

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

Dasantila BEJKO

SOKOL TONA